

## **MENAXHIMI I MBETJEVE URBANE NË AUDITIMET E PERFORMANCËS**

*nga Elfrida AGOLLI – Audituese e parë,*

*Alfred ZYLFI – Auditues i lartë<sup>1</sup>*

*botuar në gazetën “Koha jonë”, më 29 janar 2014 dhe gazetën “Ekonomia”, më 30 janar 2014.*



“Nuk e trashëgojmë Tokën nga paraardhësit, por e huazojmë atë prej fëmijëve tanë”.

Departamenti i Auditimit të Performancës në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në punën e tij audituese është fokusuar gjerësisht në problemet mjedisore e konkretisht përgjatë vitit të kaluar në trajtimin e mbetjeve, veçanërisht atyre të ngurta. Ky fokusim buron nga rëndësia dhe ndikimi direkt e indirekt që mbetje të tilla, të patrajtuara siç duhet, gjenerojnë në gjendjen e mjedisit e shëndetit publik sot e në të ardhmen. Mesazhi kryesor i auditimit ka theksuar se politikat dhe planet e menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta duhet të jenë më të fokusuara në drejtim të minimizimit të tyre dhe përmirësimit të proceseve të riciklimit. Ky mesazh ka adresuar jo vetëm palët direkt përgjegjëse, siç mund të jenë shërbimet komunale në varësi të Bashkive apo Komunave përkatëse, jo vetëm zyrtarët e Ministrisë së Mjedisit që hartojnë e implementojnë strategji për konservimin e përmirësimin e mjedisit, por veçanërisht ndërgjegjësimin e qytetarëve të cilët i shkaktojnë këto mbetje dhe duhet të jenë më aktivë në reduktimin e riciklimin e tyre. Nëse duam që brezat e ardhshëm të mos jenë të kërcënuar të “notojnë” mbi pirgje mbetjesh është e domosdoshme të kemi një menaxhim sa më efektiv të tyre

dhe një informim sa më të madh të publikut, si investitori dhe përfituesi më i madh në mjedis.



Figura 1: Koncepti i trajtimit të mbeturinave në vendet e zhvilluara Evropiane



Menaxhimi i mbetjeve është një faktor kyç, si për vendet e zhvilluara ashtu dhe për ato jo të zhvilluara në lidhje me përkujdesjen ndaj shëndetit njerëzor dhe mbrojtjen e mjedisit.

Menaxhimi jo i përshtatshëm i mbetjeve mund të sjellë kontaminimin e tokës, ujërave sipërfaqësore e nëntokësore, si edhe të ajrit.

Vendet e zhvilluara kanë krijuar e zhvilluar konceptin e trajtimit të mbetjeve, të cilit duhet t'i përmbahemi

në mënyrë që të adoptojmë mënyrat më të reja të trajtimit dhe të fillojmë implementimin e tyre në vendin tonë.

Nevoja për një mjedis të pastër nxit hartimin e planeve e programeve për të luftuar ndotjen e mjedisit nga mbetjet. Parimet themelore të kësaj “luftë” kundër mbetjeve janë:

- a. Parimi i parandalimit dhe krijimit të mbetjeve, që nënkupton se më efektiv rezulton zvogëlimi i sasisë së mbetjeve të prodhuara, sesa përmirësimi i metodës së trajtimit të tyre;
- b. Parimi “ndotësi paguan”, që do të thotë se ata që janë përgjegjës për prodhimin dhe derdhjen e mbetjeve duhet të jenë përgjegjës edhe për mbulimin e shpenzimeve të nevojshme për trajtimin e tyre;
- c. Parimi i kujdesit, sipas të cilit duhet të parashikohen të gjitha mundësitë dhe pasojat prej prodhimit të mbetjeve edhe pse ende nuk ka argumente shkencore se këto mund të ndodhin. Duhet marrë masat e nevojshme pa pritur që më parë të shfaqen problemet e pastaj të veprohet.
- d. Parimi i afërsisë, sipas të cilit mbeturinat duhet të depozitohen sa më afër vendit të krijimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, përmes auditimit të performancës ka audituar gjatë vitit 2013, me ndihmën dhe konsulencën edhe të prof. Sazan GURI, "Menaxhimin e Mbetjeve Urbane" në rastin e Bashkisë Fier.

Rëndësia e këtij auditimi qëndron në faktin se gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e tij janë një burim i çmuar informacioni e edukimi për palët e interesuara, duke qenë se mbetjet konsiderohen ndër problemet kryesore që kërkon zgjidhje të menjëhershme për shkak:

- të sasisë së përgjithshme të tyre;
- të përbërjes dhe ndikimit negativ në mjedis;
- të impaktit në shëndetin publik, etj.

Pavarësisht punës serioze të Bashkisë Fier, grupi i auditimit arriti në një sërë përfundimesh të vlefshme, një pjesë e të cilave listohen si vijon:

- Mungesa e politikave të duhura për mbetjet, në lidhje me parandalimin e tyre, grumbullimin, trajtimin dhe depozitimin si dhe mungesa e një shërbimi të përshtatshëm ka bërë që në zona të ndryshme të qytetit, sidomos në brigjet e lumenjve të gjenden përgje mbeturinash të tipeve nga më të ndryshmet, duke i kthyer këto zona në të ashtuquajtura vend-depozitime të jashtëligjshme mbetjesh dhe ç'është më e keqja në zona të ndotura;
- Pikat e grumbullimit të mbetjeve nuk janë brenda standardeve të kërkuara, kontenerët janë shumë të vjetër dhe disa prej tyre tejet të amortizuar, mbetjet vazhdojnë të depozitohen në pika të hapura prej betoni ku mbetjet hidhen të gjitha bashkë, shpërndahen lehtësisht, ndotin ambientin dhe janë lehtësisht të manipulueshme nga faktorë të jashtëm si era, endacakët, fëmijët, kafshët, etj. Shenjat dalluese të konteinerëve të cilat tregojnë për llojin e mbetjeve që duhet të depozitohen qytetarët pothuajse nuk dallohen;
- Administrimi i mbetjeve spitalore (shiringa, age, epruveta të cilat përdoren për analiza, ambalazhet e ndryshme të serumeve, etj.), bëhet në kushte të rënda higjieno-sanitare, në kontenerët mbrapa spitalit Rajonal të Fierit dhe në mjediset përreth tyre, të hedhura rëndom përtokë, ku depozitohen nga qytetarët edhe mbetjet e ngurta

urbane. Administrimi në këtë mënyrë i mbetjeve spitalore, përbën një burim të përhapjes së infeksioneve e sëmundjeve të rrezikshme për qytetarët;

- Transporti i mbetjeve urbane realizohet me mjete të vjetëruara dhe të amortizuara;
- Vendi i depozitimit të mbetjeve të Bashkisë Fier shfrytëzohet prej 40 vjetësh dhe është jashtë të gjithë parametrave dhe standardeve. Mbetjet e hedhura në të çlirojnë e përhapin në ajrin përreth gazra toksikë që përbëjnë problem tejet serioz për shëndetin e qytetarëve, Projekti i iniciuar nga Bashkia Fier për ndarjen në burim të mbetjeve urbane me qëllim riciklimin e tyre nuk ka përmbushur objektivat e paracaktuara, si rezultat i përzjerjes së mbetjeve në sistemin e grumbullimit në kontenerë me 3 ndarje, transportit dhe përpunimit të tyre;
- Programet e hartuara dhe të realizuara për edukimin publik kanë qenë sporadike, nuk janë përqëndruar në çështjen e nxehtë të menaxhimit të mbetjeve urbane në qytet drejt rritjes së ndërgjegjësimit të komunitetit në lidhje me çështjet mjedisore dhe përkujdesjen ndaj ambientit përreth, Në këtë auditim KLSH ka dhënë mesazhin kryesor “Bashkia Fier të realizojë ngjitjen e shkallëve në skemën e “Hierarkisë së Mbetjeve” me synim rritjen e cilësisë së shërbimit për qytetarët e saj”.

#### **Rekomandimet e KLSH**

Gjithashtu, auditimi gjeneroi disa rekomandime me objektiv kryesor, krijimin e impaktit pozitiv ndaj shëndetit të qytetarëve dhe komponentëve të mjedisit, ajrit, ujit, tokës si:

- krijimi i standardeve bashkëkohore për menaxhimin e mbetjeve bazuar në ato të BE-së;
- të gjendet forma më e mirë e kryerjes së shërbimit e menaxhimit të mbetjeve;
- të ndërtohet infrastrukturë të plotë për ndarjen e materialeve të riciklueshme;
- të stimulohet dhe mbështetet sektori privat lidhur me materialet e riciklueshme;

- të krijohet fond mjedisor për të mbështetur projektet e informimit dhe ndërgjegjësimit të publikut;
- të llogaritet kosto e plotë e menaxhimit të mbetjeve urbane dhe të planifikohet buxheti bazuar mbi këtë kosto;
- Bashkia Fier në bashkëpunim me njësitë administrative si Vlora, Lushnja, Berati dhe me komunat përreth të konvergojnë drejt ndërtimit të një landfill-i rajonal.

---

<sup>1</sup> *Shkrime të tjera të botuara nga Elfrida AGOLLI dhe Alfred ZYLFI për periudhën Janar–Qershor 2014:*

- *KLSH, pionier në auditimin e performancës dhe planifikimin strategjik të tij.*  
( Botuar në gazetën "Koha jonë", më 30 maj 2014.)